



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:183641

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05626007

P.nr.3518/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit N.K., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër PP.II.nr.2503/18 e datës 16.08.2018, jashtë seancës gjyqësore duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.2503/18 e datës 16.08.2018.

II. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit N.K. , nga babai N., nëna Sh., e gjinisë C., i lindur me datë ....., në fshatin ....., Komuna e Fushë Kosovës, ku edhe tani jeton në "...", pç.nr., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ....., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-ës sepse ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale.

III. I dëmtuari S. B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

IV. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me datë 23.08.2019, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër, PP.II.nr.2503/18 e datës 16.08.2018, kundër të pandehurit N.K., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-ës.

Gjyqtari i çështjes pas analizimit dhe shikimit të të gjitha provave dhe përkundër ndërmarrjes së gjitha veprimeve ligjore në mënyrë që të sigurohet prezenca e të pandehurit dhe që ndaj tij të zhvillohet procedura penale konsideron se vepra penale e cila i vihet në barrë të pandehurit të lartcekur, tanimë është përfshirë në parashkrim të ndjekjes penale sepse nga koha e kryerjes së veprës penale e deri më tani kanë kaluar më tepër se 6 vite, kohë kjo që shpie në parashkrim absolut të ndjekjes penale.

Nga shkresat e lëndës shihet se është caktuar disa here seanca për shqyrtim fillestar por te cilat nuk janë mbajtur sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e tyre si dhe me qëllim të sigurimit të prezencës së të njëjtit në procedurë ka lëshuar urdhër arrest. Tutje, duke vepruar në këtë çështje penale, përkundër përpjekjeve dhe veprimeve procedurale të ndërmarrura deri më tani, gjykata ka vërejtur se nuk mund të ndërmerë më asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penale të të akuzuarit sepse ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale. I pandehuri i lartcekur, veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-ës sipas aktit akuzues së lartcekur, dyshohet se e ka kryer me datë 05.04.2018, ku për këtë lloj të veprës penale dënimi sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës me numër 04/L-082, është e dënueshme me burgim deri në 3 vite.

Në nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së është përcaktuar se “ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”, ndërsa në nenin 107 paragrafi 8 të KPRK-së, është parashikuar se ndjekja penale nuk mund të ndermirret nëse ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), e në rastin konkret kanë kaluar më tepër se gjashtë (6) vite, kur dyshohet se është kryer vepra penale e lartcekur.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata e mori duke u bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 3 të KPP-së.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale dhe në bazë të nenit 357 paragrafi 1 në nën paragrafi 1. 3, si dhe nenit 453 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 3518/18, Me datë 26.04.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dibran Jusufi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.